

**DREJTORIA E RAJONIT VERIOR SHKODER**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Data 26.10.2018

Për: **B.O “ EKSLUZIV” sh.p.k**, me përfaqësues ligjor Z. Rexhep Ruçi, me adresë *Rreshen, Lezhe, Nr NIPTI J 69102021 W & “MELA” sh.p.k*, me përfaqësues ligjor Z.Elton Manka, me adresë: *Rr. “ Maliq Muço”, Ndertesa Nr 6, Hyrja 4, Ap.14, Njësia Bashkiake Nr 9, Tirane*, me NR **NIPTI K 62320011 G**, përfaqësuar bashkimi nga **“ EKSLUZIV” sh.p.k**, me përfaqësues ligjor Z. Rexhep Ruçi  
Procedura e prokurimit: *“E Hapur”*  
Numri i referencës së procedurës/lotit : **REF-73904-06-07-2018**  
Përshkrim i shkurtër i kontratës:

**“Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga "U.Matit -Rrëshen (Ura e Fanit), Rrëshen (U.Fanit)- Shpal, Shpal- Q.Benë- K.Hadroj, Shpal-Ura e Repsit 84.9 km ”.**

**Me fond limit: 64.859.900 leke pa tvsh** (gjashtëdhjetë e kater milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind) leke pa tvsh/Buxheti i Shtetit. Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data 11.06.2018] [Numri 23]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Në këtë procedure prokurimi moren pjesë **5 (pesë) ofertues**, operatorë ekonomik, përkatësisht:

1. **B.O “DRINI 1” shpk**, me përfaqesuese ligjore Zj.Pellumbesha Martini, me adrese: Rr. "Ymer Puka" , Blloku Nr.03 Puke, me NR NIPTI J 78716317 H, **kuotë përfaqësimi 51 % & “AEK MUNELLA” sh.p.k**, me përfaqësues ligjor Z.Zef Kaza, Njesia Administrative Fan, Mirdite, Nr NIPTI J98926001P, **kuotë përfaqësimi 49 %**, përfaqësuar bashkimi nga Z. Pellumbesha Martini, me oferte: 55 536 492 (pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e katerqind e nëntëdhjetë e dy **leke pa tvsh**, 66 643 790 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e dyzet e tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë) **leke me tvsh**.
2. **B.O “EKSLUZIV” sh.p.k**, me përfaqësues ligjor Z. Rexhep Ruçi, me adrese Rrëshen, Lezhe, Nr NIPTI J 69102021 W, **kuotë përfaqësimi 93%**, & **“MELA.” shpk**, me përfaqësues ligjor Z.Elton Manka, me adrese: Rr. “ Maliq Muço”, Ndertesa Nr 6, Hyrja 4, Ap.14, Njësia Bashkiake Nr 9, Tirane, me NR NIPTI K 62320011 G, **kuotë përfaqësimi 7 %**, përfaqësuar bashkimi nga Z. Rezhep Ruçi, me oferte: 60 285 426 (gjashtëdhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katerqind e njëzet e gjashtë) **leke pa tvsh**, 72 342 511,2 (shtatëdhjetë e dy milion e treqind e dyzet e dy mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë presje dy) **leke me tvsh**.
3. **“FLORIDA ” shpk**, me numer NIPTI J79602604P, me përfaqësues ligjore Z.Zeqir Bushgjoka, adrese: Bajram Curri, me oferte: 63 002 558 (gjashtëdhjetë e tre milion e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tetë ) **leke pa tvsh**, 75 603 070 ( shtatëdhjetë e pesë milion e gjashtëqind e tre mijë e shtatëdhjetë) **leke me tvsh**.
4. **“GECI” sh.p.k**, me numer K 71829801 O, me përfaqësues ligjor Z.Ram Geci, me adrese: “Tirana International Hotel”, Sheshi “Skenderbe”, Tirane, me oferte: 63 555 998 (gjashtëdhjetë e tre milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë) **leke pa tvsh**, 76 267 198 (shtatëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë ) **leke me tvsh**.

**5. Person fizik Z.Adem Pojani.**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

**Te s’kualifikohen këta operatore ekonomik:**

**1. Adem Pojani**

*Përkatesisht per arsyet e meposhtme:*

Nuk plotëson asnjë nga kriteret e kualifikim pasi nuk është ngarkuar asnjë dokument ligjor në sistem.

## 2. B.O “DRINI 1” sh.p.k& “AEK MUNELLA” sh.p.k

*Përkatesisht per arsyet e meposhtme:*

1. Bilancet kontabel te viteve 2016, 2017 te shoqerise "DRINI- 1" nuk jane te shoqeruara nga raportet e audituara.
2. Akt marrveshja nr.3850 REP, Nr.793 Kol, date 26.06.2018 ku shenohet ndarja: “AEK MUNELLA” me 49% dhe “DRINI 1” me 51% , ndarja e makinerive nuk eshte bere sipas perqindjes se kontrates se bashkepunimit , konkretisht per mjetet e punes borepastruese.

## 3. “FLORIDA” sh.p.k

*Përkatesisht per arsyet e meposhtme:*

Nuk plotësoni kriteret per kualifikim mbasi keni perdorur te njejtat makineri e paisje te cilat i keni tek *objekti " Mirmbajtje Rutine e dimrore me performance B.Curri-Valbone,U.Bujanit-Q.Morine "* ku jeni shpallur fitues.

## 4. “GECI “ sh.p.k

*Përkatesisht per arsyet e meposhtme:*

Nuk plotësoni kriteret per kualifikim mbasi keni perdorur te njejtat makineri e paisje te cilat i keni tek objekti "*Mirmbajtje Rutine e dimrore me performance Fierze-B.Curri -Kam "* ku jeni shpallur fitues.

\* \* \*

## 2. Te kualifikohen:

**Operatori ekonomik B.O “ EKSLUZIV” sh.p.k, & “MELA”sh.p.k** pasi ploteson kushtet per kualifikim, sipas kriterëve te percaktuara ne Dokumentat Standarte te Tenderit.”

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik: **B.O “ EKSLUZIV” sh.p.k**, me përfaqësues ligjor Z. Rexhep Ruçi, me adrese *Rreshen, Lezhe, Nr NIPTI J 69102021 W, kuotë përfaqësimi 93%, & “MELA” sh.p.k, me perfaqesues ligjor Z.Elton Manka, me adrese: *Rr. “ Maliq Muço”, Ndertesa Nr 6, Hyrja 4, Ap.14, Njësia Bashkiake Nr 9, Tirane*, me NR NIPTI K 62320011 G, **kuotë përfaqësimi 7 %**, përfaqësuar bashkimi nga Z. Rezhep Ruçi, me oferte: 60 285 426 (*gjashtëdhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katerqind e njëzet e gjashtë*) **leke pa tvsh**, 72 342 511,2 (*shtatëdhjetë e dy milion e treqind e dyzet e dy mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë presje dy*) **leke me tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.*

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorise Rajonit Verior Shkoder,me adrese: *“Rr.At Zef Valentini”*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (*pese*) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin -.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **27.07.2018**

Ankesa: **Po**

Brenda afatit ligjor 7 ditor ka paraqitur ankese Shoqeria **B.O “DRINI 1” sh.p.k& “ AEK MUNELLA” sh.p.k**, protokolluar prane AK me nr.321, date 02.08.2018.

Autoriteti Kontraktor ne lidhje me kete ankese ka dale me vendimin e dates 07.08.2018, percjelle subjektit me shkresen nr 331 prot, dt.08.08.2018, duke refuzuar ankesen.

Me date 22.08.2018, protokolluar nga AK nr 356 prot, shoqeria **B.O “DRINI 1” sh.p.k& “ AEK MUNELLA” sh.p.k**, i është drejtuar KPP-se. Ankesa fillimisht rezulton e dorezuar ne nje date te meparshme ne KPP , konkretisht dt.15.08.2018, Nr. rendor 1396.

KPP me vendimin Nr 1396/1, dt.16.08.2018, protokolluar nga AK me nr 346, date 20.08.2018, vendosi pezullimin e procedures se prokurimit dhe shqyrtimin ne themel.

Me shkresen nr 356 prot, dt.24.08.2018, AK informoi Komisionin e Prokurimit Publik mbi ecurine dhe hapat e ndermarre nga AK, ne lidhje me trajtimin ligjor te ankeses.

KPP me vendimin nr 713/2018, percjelle AK-së me shkresen nr 713/1 prot, dt.23.10.2018, protokolluar nga AK me nr 432, dt. 25.10.2018, ndër të tjera ka vendosur mos pranimin e ankesës së operatorit **B.O “DRINI 1” sh.p.k& “ AEK MUNELLA” sh.p.k** dhe lejimin e AK që të vijojë me hapat e mëtejshem procedural.